

NACIONAL

Drejtore:
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com buçpapaj@yahoo.com



Shpaloja e krizës në Luginën e Preshevës

Dallimi në mes të të drejtave të garantuara për serbët që jetojnë në veri të Kosovës (që përfshinë edhe lidhjet e tyre me institucionet në Serbi) dhe mohimit të të drejtave njerëzore dhe qytetare të shqiptarëve të Luginës së Preshevës (duke përfshirë casjen në institucione në Kosovë dhe Shqipëri) është tmerrësisht jofer, shkelë standardet ndërkombëtare dhe është krejtësisht i paqëndrueshëm.

Nga Shirli Cloyes DioGuardi

faqe 2



Në sajë të Shqipërisë

Për shumë vite më ka mundur barra e madhe se nuk qesh në gjendje t'iu mundësoja Njazi dhe Liza Lotte Pilkut të nderoheshin dhe të merrnin statusin e TË DREJTËVE MES KOMBEVE. Ata e meritonin këtë mirënjohje për shkak të guximit dhe miqësisë që kishin treguar ndaj nesh, pavarësisht nga rreziqet në të cilat e vinin veten.

Johanna Jutta Neumann (Gerechter)

faqe 21

Ballkani, kërcënimi më i madh për Evropën në 2009



Dennis Blair

Drejtori i Inteligjencës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara, Dennis Blair, ka paraqitur para Kongresit raportin me kërcënimet kryesore të sigurisë në botë. Ballkani gjithashtu ishte pjesë e raportimit.

Ngjarjet në Ballkan sërish paraqesin kërcënimin më të madh për stabilitetin e Evropës gjatë vitit 2009, pavarësisht zhvillimeve pozitive të vitit të fundit, siç ishin shpallja paqësore e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, zgjedhja e udhëheqësve pro BE-së në Beograd dhe marrja e ftesës për anëtarësim në NATO nga Shqipëria dhe Kroacia.

faqe 3

PASAPORTA E IDENTITETIT

Nga Lindita SEJDIU
Shkup

Një prej standardeve më të fuqishme që kërkohen në rrugën e integrimit të popujve në familjen e madhe europiane, është sensi i kultivimit të identitetit kulturor. Kultura, është shpirti që i jep fizionomi trupit tonë të gjymtuar kombëtar, karshi botës së përparuar dhe karshi proceseve të rënda që na sfidojnë si komb, pa marr parasysh hapësirën gjeografike ku jetojmë. Në këtë aspekt, një kulturë e përbashkët, e integruar, e pagjymtuar, sipas klaneve e grupeve të caktuara, rajoneve e grupeve gjuhësore, do të shërbente në ngritjen e kombit në pedestalin e kombeve të kulturuaruara perëndimore për t'u rikthyer dinjitetshëm në këtë familje.

faqe 3

VEPRA E KADARESË DHE IDETË ANTITOTALITARE

faqe 16

Nga ARBEN VESELAJ



NUK DI QYSH DHE NË FERR DASHURISË I BESUAM

Poezi nga Vebbi Skënderi

faqe 4



faqe 12

Shën Valentini dhe Stina e Dashurisë

Festa e Shën Valentinit nuk është festa e fejesës me dikë, por e të qenurit i dashuruar, është kujtimi dhe falenderimi për perëndinë e Erosit, për plagët që na shëron në të vdekshmëve, kur të tërhequr drejt një qenieje tjetër, biem në atë "maladie d'amour" (sëmundje dashurie) që na komplikon jetën, duke alternuar momente dallie dhe ekstaze me kriza melankolie, ligështimi dhe vetmie, sapo i dashuri largohet nga horizonti ynë.

Nga Elida BUÇPAPAJ

faqe 11	Dikush që ju adhuron Poezi nga Maya Angelou:
faqe 20	Mbidrinasi i madh i poezisë Profil poetik nga Skënder Buçpapaj
faqe 21	Shqiptarët në Siujdhesen Ballkanike Nga Prof. Rexhep Krasniqi
faqe 8	Kohë e çmendur tregim nga Zhuliana Jorgaxhi
faqe 14	Po kthehem zemërthyer Poezi nga Jaho Margjeka
faqe 7	Lejlekët nuk fluturojnë më Tregim nga Bahri Myftari
faqe 19	Heroi i dy kontinenteve nga Gjekë Marinaj
faqe 18	Mirëkuptim Poezi nga Almona Bajrami

“*Maya Angelou u lind në St. Louis, Missouri, më 4 Prill, 1938. Ajo është vlerësuar lart nga kritika dhe lexuesi Amerikan jo vetëm si poete, por edhe si historiane, dramaturge, regjisore, këngëtare, dhe si aktiviste e të drejtave humane. Maya Angelou është aq e njohur midis popullit Amerikan, sa është e vështirë që të hasësh ndonjë amerikan që nuk e ka dëgjuar emrin e saj, gjë që nuk mund të thuhet për asnjë poet tjetër amerikan të kohës sonë. Ajo ka botuar mbi 30 libra të gjinive të ndryshme dhe ka fituar disa çmime letrare. Maya Angelou ishte e zgjedhura e Presidentit Klinton për të lexuar poezi ne ditën e inaugurimit të tij më 20 janar 1993.*”

FUND TETORI

Me kujdes
gjethet e vjeshtës
spërkasin poshtë grimcat
e tingujve të vdekjeve
dhe qiejt hidhërohen
nga dielli faqekuq
nga agimi i trëndafilte
i nxehur pa ndërprerje
në grackat e hirta të kthimit
në të zi
për ngushëllim.

Vetëm të dashuruarit
e shohin atë vjeshtë
një sinjal për fund të fundeve
një gjest rrëshqitës që zgjon
ata që nuk do të alarmohen
kur ne fillojmë të ndalojmë
me qëllimin e thjeshtë
që të fillojmë
nga e para.

KUJTESË

Xhinde të grikthet zvarriten nën mëngët e mia
të nxjerrin kokën tek sytë e mi
kur nga brenda ua mohoj kërcënimet
dhe u përgjigjem me gënjeshtra.

Memoriet e mija të qullosura luajnë
Një ritual në buzët e mia
Unë shtrihem në dëshpërimin flegmatik
Dhe ata ma ndajnë shpirtin në rripa.

TË SHKËPUTURIT

Ne vdesim,
Duke mirëseardhur mjekrat e kaltra në errësira,
Shtrënguesit e qafave tona plotësisht të shtrira.
Shtrënguesit, që as nuk duan t'ia dinë as
As nuk e dinë se
VDEKJA ËSHTË E BRENDSHME.

Ne lutemi,
Tek shijojmë gënjeshtrat e ëmbla nëpër dhembë,
Duke zvarritë barkun për dhë para zotave të huaj,
Zotave që as nuk duan t'ia dinë as
Nuk dëshirojnë ta dinë se
FERRI ËSHTË I BRENDSHËM

Ne dashurojmë,
Duke e fërkuar lakuriqësinë me dorashka në duar,
Duke përrjargur gojën me puthje gjuhë më gjuhë,
Puthje që as nuk prekin as
Që duan të prekin nëse
DASHURIA ËSHTË E BRENDSHME

E SHKRETA VAJZË

Ju keni gjetur një tjetër të dashur
dhe unë e di këtë
Dikë që ju adhuron
tamam si unë
Varur në fjalët e tua
si të ishin prej ari
Duke menduar së ta kupton
shpirtin
e shkreta vajzë
tamam si unë.

Ju po thyni një tjetër zemër
dhe unë e di këtë
Dhe nuk mund
të bej asgjë
Nëse provoj t'i tregoj asaj
ato që di
Ajo do më keqkuptojë
dhe do më bëjë të ikë
E shkreta vajzë
tamam si unë.

Ju do e leni edhe atë
dhe unë e di këtë
Ajo nuk do e dijë
ç'të bëri të ikësh
Ajo do qajnë dhe pyesë veten
Çfarë shkoi mbrapsht
Pastaj do të fillojë
të këndojë këtë këngë
E shkreta vajzë
tamam si unë.

AMERIKA

Ari i premtimeve të saj
kurrë nuk është gërmuar

Kufijtë e drejtësisë së saj
të pa përkufizuar pastër

Bollëku i bereqetit të saj
fryti dhe fara

Nuk e kanë ushqyer të uriturin
as lehtësuar dhimbjen e thellë

Deklaratat e saj krenare
janë gjethe në erë

Ekspozimi i saj jugperëndimor
shoqëroi vdekjen e zezë

Zbuloje këtë vend
shekujt e vjetër qajnë

Ndërto blloqe madhështore
Që askush të mos i përl

“Ajo vret të ardhmen e ndritur të saj
Dhe përdhunon për një soe

Pastaj u bën kurth fëmijëve
Me legjendat e rreme”

Të lutem

Zbuloje këtë vend.

NGA
MAYA ANGELOU

Dikush që ju adhuron



POZË DINAKE

E gjetheve në rrëzim dhe e borërave
në shkrirje, e zogjve
në adhurim
tek disa poetë këndojnë
meloditë e tyre
duke m'i zbutur netët
me ëmbëlsi.

Lapsi im lëkundet
Dhe nuk ecën dot
Përgjatë shtegut të heshtur
Kur kam nevojë të shkruaj
Për të dashuruarit flas

Dhe të urrej
Me ngut
Urrejtimen e tërbuar.

ELEGJI

Për Harriet Tubman dhe Frederick Douglass

Shtrihem në varrin tim
dhe shoh fëmijët e mi
tek rriten
si lulesa krenare
përmbi barishtet e vdekjes.

Petalet e tyre përshëndesin
dhe prapë askush
nuk e vëren dheun e zi
dhe të butë të bërë çarçaf
mbi mua. Krimbat, miq,
prapë tunele të hapura
në eshtra dhe përmes atyre
vrimeve unë shoh shiun.
Ngrohja diellore
tani godet
brenda hapësirës time dhe
më sjellë rrënjët e
e fëmijëve të lindur.

Farëzat e tyre duhet të bien
dhe të shtypen poshtë
kësaj toke
dhe të më gjejnë aty ku
i pres. Nevoja ime e vetme
që t'ua polenizoj lindjen.

Shtrihem në varrin tim
dhe i shoh fëmijët e mi
tek rriten.

LEKSIONI

Vazhdoj të vdes përsëri.
Damarët dobësohen, hapen si
Grushtet e vogla të fëmijëve
Të përgjumur.

Kujtimet e muhabetëve të varrit,
Lëkurat e kalbura dhe krimbat nuk
Më bindin të kthehem kundra
Sfidës. Vitet
Dhe mundimi i jetës së ftohtë
Me thellohen në rrudhat e fytyrës.
Ato m'i mpijnë sytë, megjithatë
Unë vazhdoj të vdes,
Sepse e dashuroj jetën.

KOCEPTIM I DREJTË

Takova një zonjë poete
që frymëzohej nga
zogjtë e ngjyrosur, dhe fjalët fishkëlyese,
nga hezitimi i një të dashuruarit.

Një gjethe në rrëzim mund ta trazonte.
Një lëkundje, një trëndafil në tharje,
do e shtynte të shkruante ditë e natë,
prozën më shpërblyese.

Ajo mund të hetonte një mendim të fshehur
në çdo palë pantallonash,
pastaj të ngutej të gjendej e vetme në shtëpi
dhe të shkruante për dashurinë.

VENDIMI I FUNDIT

Shkrimi është tepër i vogël, më shqetëson.
Lëkundje gjërash të zeza nëpër faqe.
Përdredhje fjalësh gjithandej.
E di se i ka mosha këto.
Do më duhet ta lë leximin.

Ushqimi është tepër i yndyrtë, më revoltton.
E përpjij të nxehtë ose e shtyj poshtë të ftohtë,
Më merr gjithë ditën-fytin mos e kaloftë.
Ka q e lodhur sa jam, e di se më ka zënë
pleqëria.
Do më duhet ta lë ushqimin.

Shqetësimet e fëmijëve po më lodhin.
Rrinë pran shtratit tim dhe u dridhen buzët,
Nuk dëgjojnë dot një fjalë të vetme,
Më mirë ta lë edhe të dëgjuarit.

Jeta është shumë e ngarkuar, po më këputë.
Pyetje dhe përgjigje dhe mendime të thella.
Kam zbritur dhe mbledhur dhe shumëzuar,
Shuma e llogaritjeve me del e shpërfillët.
Sot do e lë edhe jetën.

*Shqipëroi
Gjekë Marinaj*

Libri i shkrimtarit Ndue Hila, titulluar *Heroi i Dy Kontinenteve*, tëlënëpërshypjenseështëshkruar me “lot” e jo me bojë. Si mund të jetë ndryshe kur bëhet fjalë për jetën e kufizuar vetëm brenda 22 viteve të lezhjanit Gentian Marku, i cili u vra në frontin e parë të luftës në Irak, më 25 nëntor, 2004. Libri i Hilës është një monografi e avancuar. Forca krijuese e autorit dhe imazhi heroik i Gentianit, të njësuara, të duket sikur i japin një dimension shtesë kësaj veprë. Kjo është diçka për t’u lavdëruar në punën e autorit, sepse njëra nga arsyet që monografive nuk u jepet vëmendja e merituar nga lexuesit është mungesa e prezencës së një elementi esencial-mbledhja e informacionit të saktë the plotë. Hila i ka kushtuar kohën dhe dedikimin e duhur studimit të fakteve që pasqyrojnë jetën, vdekjen e më pas kujtimin e heroit.

Letrat e rëndësishme, si kjo që vijon, flasin më shumë se sa ç’ mund të thoshte me tekst autori: “Jam thellësisht i mërzhitur për humbjen e djalit tuaj Tetar Gentian Marku, që ishte i inkuduar në ushtrinë Amerikane. Gentiani ishte i shkëlqyer në shërbim të lirisë së Irakut. Ai ka ndihmuar për ruajtjen dhe sigurimin e atdheut tonë, të Amerikës sonë të shtrenjtë. Shteti ynë nuk do ta harrojë sakrificën, bujarinë, devotshmërinë e tij, në përpjekjet tona për një botë më të qetë dhe të lire. Ne shpresojmë se juve do të gjeni forca tek besimi juaj si dhe të dashuria dhe përkrahja e familjes dhe dashamirëve tuaj. Ne do ta kemi gjithmonë në kujtesë Gentianin. Laura dhe unë ju dërgojmë ngushëllimet tona. Zoti ju bekoftë. Sinqerisht, George W. Bush.”

Ky libër është i fuqizuar me detaje substanciale rreth heroit. Ato kanë rëndësi absolute për monografinë. Një e veçantë që meriton vëmendje është fakti se shkrimtari është i përfshirë tërësisht në vepër. Ai paraqitet një aktivist aktivë në rolin e tij si njeri dhe bashkëqytetar i heroit.

Bashkimi i pjesës faktike me komponentët e tjerë letrar integrohen me efektivitet nga fillimi deri në fund. Eksplorimi i autorit drejt portretit të heroit fillon që në faqet e para. Imazhi i të riut lezhjan vishet me rëndësinë e merituar që nga muaji Maj i vitit 2003, kur bënte pjesë në stërvitjen e trupave amerikane në Shqipëri. Përvoja personale dhe spontaniteti i diskursit intelektual të autorit kanë shërbyer si elemente vitale në cilësinë artistike dhe letrare të librit. Ai i është nënshtruar një intensiteti profesional të theksuar për të arritur nivelin e cilësive që ka arritur.

Nisur nga ky perceptim mund të themi se korrespondenca e familjes dhe miqve me Gentianin është paraqitur e plotë dhe pa asnjë lloj censure. Ato janë të natyrës së kësaj letre ku heroit informon familjen e tij për vështirësitë dhe rrezikun që kalon ai (dhe grupi që ai drejton) nga dita në ditë, nga javë në javë: “Përsëritet Jona, Mirë je? Mami e babi mirë janë? Unë jam mirë. Katër javët e ardhshme do jenë pak të rrezikshme këtu, sepse do përpiqemi të marrim nën kontroll një qytet i cili quhet Felujah. Kemi lajmëruar të gjithë ato që jetojnë aty të largohet nga qyteti, se do të shkojmë ta marrim me forcë, kundra kujt do që të dalin para për luftë. Do mundohem të marr

nesër në telefon, në qoftë se kam mundësi. S’kam karta këtu por dua të uroj Gëzuar Ditëlindjen! Me dashuri, vëllai juaj Genti.”

Heroi i Dy Kontinenteve, si pjesë e kreativitetit jo-fiktiv të Hilës, është një çelës që mund të hapë dyer të mëtejshme kurioziteti, duke e mbajtur në një nivel të lartë linjën emocionale dhe dhembjen shpirtërore për heroin e veprës. Gentian Marku i jepet lexuesit si një djalosh me një edukatë dhe maturi të pashoqe, si një i ri që pat kërkesa të qarta për tu bërë dikush në jetë, por edhe i vetëdijshëm për barrierat dhe rreziqet që mund të takonte gjatë rrugës për tek idealet e larta që kishte si njeri dhe si marins. Orvatjeve të tij

për rezultate të pastra dhe përpjekje të sinqerta, Hila u ka dhënë hapësirën e duhur në libër. Një dokumentacion i pasur, herë i komentuar e me shpesh evident në formë fotokopje; si dëftesa shkollëre ashtu edhe diplomat e trajnimeve të ndryshme në karrierën e tij të re, zënë një vend të dukshëm në këtë vepër. Hila e ka shtruar këtë aspekt të ilustruar nga korrespondencat konkrete që heroit ka mbajtur me miqtë, shokët dhe mësuesit e tij. Kjo letër është një prej tyre, e cila dëshmon për kualitetet e heroit si një njeri që ka afirmuar të dyja, aftësitë edhe dëshirën, për të shkruar një hap më larg se sa ç’kërkohej prej tij: “Gentian, ka qenë një kënaqësi që të kam pas në klasë këtë semestër. Do kisha pasur shumë dëshirë që të kisha pas në klasë për gjithë vitin. Ju ishit një ndihmës shumë i mire për mua. Më duket sikur të kam njohur prej shumë kohësh, dhe pse të kam pasë vetëm një semestër në klasë. Dhe pse tani nuk je me student, të konsideroj si një shok, ndaj të lutem më trego se si jeni. Në qoftë se keni nevojë për ndonjë gjë, ju lutem me telefononi kur të mirë për ju dhe ju uroj sa më shumë suksese në çdo gjë që bëni. Gëzuar Maturën! Me respekt nga Zonja Vohs (ish mësuesja e tij).”

Besoj se Walter. B. Jones, i cili nuk ua fshih dot prindërve të Gentianit ankthin dhe dhembjen që ndjen, do të ishte dakord me këtë mendim. Ja ç’farë u shkruan atyre: “Në kohën që jam duke shkruar këtë letër me dhemb zemra sepse e imagjinoj humbjen tuaj. Nuk gjej fjalë që ta përshkruaj keqardhjen time, për ju dhe familjen tuaj, për vdekjen e të dashurit tuaj të zemrës. Tetar Gentian Marku ka treguar guxim, trimëri dhe devotshmëri së bashku me të gjithë marinarët në misionin e tyre. Dashuria e tij ka qenë aq e madhe për këtë vend, sa nuk kurseu as jetën për te. Zoti e bekoftë familjen tuaj, e bekoftë këtë vend të bukur, këtë ‘tokë të lirisë dhe shtëpi të trimave’ që ne e quajmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sinqerisht Walter B. Jones, Kongresmeni i Sh.B.A.”

Gjithsesi, Hila ka ditur të mos e mbingarkojnë librin me linja të së njëjtës natyrë. Kjo na lë të mendojmë se konstruksioni mjeshëtor i monografisë është reflektim i përvojës së jetës së tij letrare. Balancimi struktural e bën këtë



libër më domethënës dhe më të rëndësishëm për lexuesin. Rruga primare e segmenteve jetësore të Gentianit dhe përqendrimi i autorit në arsyet që e quan heroin të mbetet hero ka rëndësi. Ajo kalon tangjent me rrethin e jetës së 22-vjetarit në një pikë kyçe-në dhënie të jetës së tij që të gjithë ne të jetojmë të lirë jashtë kufijve të frikës.

Hila e ka mbështetur këtë besim si besim edhe i të tjerëve me dy raste konkrete. E para ka të bëjë me ceremoninë mortare të heroit në Amerikë, më 5 dhjetor 2004 dhe e dyta me ceremoninë mortare në vendlindje, në Piraj të Lezhës, më 8 dhjetor 2004.

Fatos Nano është pjesë e këtij dialogu: “Të dashur miq, familjarë dhe të afërm të familjes Marku, me hidhërim të madh mora vesh humbjen e djalit tuaj, Gentianit, i cili dha jetën e tij të re në mision për të kontribuar denjësisht në operacionin “Liria e Irakut”. E kuptoj gjendjen tuaj në këto momente të vështira dhe jam me ju për të ndarë sadopak dhimbjen tuaj. Gentiani, me shembullin e tij, do të mbetet burim frymëzimi për ushtarët tanë në Shqipëri dhe për ata që kontribuojnë për paqen në Irak e kudo në botë. Toka shqiptarë e pret me bujari trupin e birit të saj, Gentianit, duke përmbushur kështu edhe dëshirat e tij. Më lejoni, në këto momente të dhimbshme, të bashkohem me ju për humbjen e Gentianit. I përgjeshëm qoftë kujtimi i tij! Sinqerisht, juaji, Fatos Nano.”

Një tjetër aspekt që e mbanë lart nivelin cilësor të këtij libri është teknika autoriale në ndërtimin e skenave historike që kanë në thelb intimitetin familjar dhe shoqëror të Heroit. Çiltërsia me të cilën jepen detajet kthehet në një përbërje vitale në qëllimin kryesor të kësaj veprë, që padyshim është njohja e publikut me heroin-një impuls shtesë drejtë kujtimin të tij. Për ta ndarë një përpjekje të tillë me kolegët e tij, sidomos me gazetarët, Hila ka përfshirë në libër një sërë artikuj gazetaresh dhe shkrime të tjera të botuara me rastin e rënies së heroit Gentian Marku. Por jo vetëm kaq. Ai ka bërë të mundshëm dokumentacionin e plotë drejtuar organeve qeveritare të Lezhës dhe Ministrisë së Mbrojtjes në lidhje me nderimin dhe kujtimin e mëtejshëm të heroit. Hila gjithashtu është ndalur edhe tek mundësitë që ekzistojnë për vënie e emrit “Gentian Marku” të një rrugë në Michigan. Ai vlerëson lart faktin që

HEROI I DY KONTINENTEVE

NJË MONOGRAFI PLOT DHEMBJE

shkolla ku Gentiani ka marrë mësimet e para si dhe rruga e fshatit Piraj, tashmë mbajnë emrin e heroit.

Po aq lart meriton të vlerësohet edhe fakti se materiali i zgjedhur nga autori është organizuar mirë brenda një kornize me dimensione të gjëra letrare. Hila ka vendosur të zgjedhë një strukturë të mbështetur në sistemin kronologjik për materialet objektive dhe në atë logjik për ato subjektive. Kështu konsiderimi i trajtimit me kujdes të çështjeve etike dhe morale ka rezultuar në një produkt përfundimtar cilësor. Për ta arritur këtë, Hila ka përdorur një kodë shkrimor që përfaqëson dhe mbanë të pastër monografinë, por pa pasë frikë që nganjëherë të paraqitet edhe me nuanca fiktive. Një fenomen i tillë shpaloset në seksionin “Jeton në zemrat e të gjithëve” i cili sjell për lexuesin disa poezi vërtet të ndjera si strofa në vijim (shkëputur nga një poezi e Lekë Gjokës) kushtuar heroit: “Dhe pret vendlindja / Që biri të tretet në dheun e vet / Gjergj Kastriotit i ringjallet fytyra / The thotë: Heronjtë gjithmonë gjallë kanë mbetë (Lekë Gjoka).

Një poezi e tille nuk paraqet ligje të domosdoshme apo receta specifike që e drejtojnë lexuesin të futet në një epitol të veçantë interpretimi. Për mundësitë interpretuese është kujdesur vetë Hila. Objektivi i tij është i qartë-përpjekja për të bërë atë që është e drejtë. Çdo gjë që ka shkruar është e sinqertë dhe e trajtuar me ndjeshmërinë dhe respektin maksimum për heroin që është dy herë hero-si në historinë e Shqipërisë dhe Amerikës ashtu edhe qendrën e veprës së Hilës. Në këtë pikë të realitetit janë radhitur një varg kapitujsh ku lexuesi njihet me disa rrefime mbi jetën e heroit nga miqtë dhe shokët të tij si nga jeta civile ashtu edhe nga ajo ushtarake gjatë të cilës janë njohur dhe kanë bashkëpunuar në stërvitje apo diku në frontin e luftës. Siç mund të pritët, këta kapituj janë të shoqëruar me disa pjesë të veçanta ku vihen në dukje edhe dekoratat akorduar heroit Gentian Marku.

Kësisoj Hila ka arritur të vë në jetë një tjetër aspekt të rëndësishëm të teknikës të së shkruarit-komunikimin direkt dhe indirekt-vendosjen e vijës ndarëse në mes të bisedave që burojnë nga rrjeti i kujtimeve me dialogun e fabrikuar apo të planifikuar më mirë të themi. Duke e ruajtur këtë ekuilibër ai bind lexuesin se libri i tij nuk është vetëm një arkiv sekuencash të dhimbshme të risistemuar sipas traditës së sekretarisë. Po kështu, edhe transkriptimi i fjalimeve të mbajtura me rastin e rënies së heroit bën pjesë në kapitujt e Heroi i Dy Kontinenteve. Midis tyre zë vend fjalimi i përfaqësuesit të ministrisë së mbrojtjes së Shqipërisë z. Dhori Spirrollari, ai i vetë autorit z. Ndue Hila, ai i nënkryetarit të veteranëve të luftës për rrethin e Lezhës z. Hyda Osmanit, si dhe fjalimi i z. Ndre Keli.

Autori, ama, nuk ka bërë kalime të shkurtra apo ngjeshje të materialit. Përkundrazi, ai i ka rezervuar vendin e nevojshëm çdo ideje. Kjo ka bërë

NGA GJEKË MARINAJ



që mendimet të shtjellohen në mënyrë natyrale duke marrë shkallëzime graduale sipas principeve tradicionale të gjinisë së monografisë. Por me të drejtë, këtij libri i është shtuar edhe një traditë shoqërore, siç është ajo e telegrameve të ngushëllimit të nënave Amerikane, telegrameve të nxjerra nga interneti, si dhe një sërë falënderimesh nga miqtë dhe shokët drejtuar familjes Marku.

Duke pasë të bëjë me një histori ku dhembja njerëzore dhe simpatia ndaj heroit janë në një lartësi maksimale, Hila ka aplikuar një mënyrë të shkruarit që i ka dhënë mundësinë e laberencës autoriale nga trishtimi i skenave tronditëse që paraqet. Ai ua lë skenave përgjigjet ndaj pyetjeve që mund të lindin rreth tyre. Trishtimi dhe lëndimi i ndjenjave që përshkojnë veprën nga fillimi deri në fund si dhe logjika e përzgjedhjeve të materialeve shërbejnë si një arsyetim i plotë që strategjia e përdoruar nga autori është e menduar dhe efikase për qëllimin që ka. Këtë e vërteton më së miri letra e fundit që heroit i ka dërguar familjes nga fronti i luftës, nga aty ku zemra e tij e re po numëronte të rrahurat e fundit: “Babi, mami dhe Jona, jam mirë dhe dëshiroj të jeni mirë si me shëndet ashtu dhe me punë. Më falni që nuk kam pasur mundësi t’ju marr në telefon, por këto dhjetë ditët e fundit kanë qenë shumë të këqija për ne. Ne jemi i vetmi grup që ka shkruar nga veriu deri në jug të qytetit. Rruga është shumë e lodhshme dhe e dhembshme; 6 nga shokët e mi nuk janë më gjallë. Njeri nga ato ka qenë një djalë i ri që ka jetuar në një dhomë me mua. Megjithatë, Zoti është duke ju përgjigjur lutjeve të mia dhe më ka ndihmuar mua dhe marinsat e që unë drejtoj të mbijetojmë. Ka dy ditë që nuk kemi pasë probleme. Në rregull pra nuk po shkruaj më gjatë. Të fala babës Ndre dhe nënës Vidë, e të fala të gjithëve nga unë, Genti.”

Ky sinqeritet i tejdukshëm dhe deri në fund njerëzor është i paraqitur në formë pamore në një album fotografik që mbyll monografinë rreth jetës së Gentianit. Së fundi, përgatitja paraprake e autorit dhe përqendrimi i mëvonshëm në zbulimet e bëra duket qartë në librin “Heroi i dy Kontinenteve.” Kjo tregon se Hila e ka familjarizuar veten me heroin dhe me peripecitë e tij. Ai e ka përgatitur veten që në rastin e nevojshëm të dinë të bëjnë pyetje të mençura dhe të ketë kërkesa inteligjente për të arritur objektivin e tij si autor i monografisë në fjalë. Me këtë ai ka bërë që njerëzit të tregohen të gatshëm të intervistohen edhe të binden se kërkesat e autorit në të mirë të heroit janë kërkesa që secili njeri i ndershëm, pavarësisht rolit që ka në shoqëri, duhet t’i konsiderojnë me kujdes.